

Objektivat kryesore të Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”

Të riintegrojë shqiptarët e riatdhesuar në shoqërinë shqiptare dhe integrojë migrantët e brendshëm.

Të zhvillojë perspektiva të reja mësimore dhe profesionale për të ardhmen e tyre, me qëllim që t'i ndihmojë ata të gjejnë dhe rizbulojnë rrënjët në Shqipëri.

Të krijojë mundësi për riintegrim nëpërmjet lehtësimit të punësimit.

Të ushqejë dhe mbajë gjallë njohuritë profesionale dhe t'i ndihmojë të rinjtë të fitojnë njohuri për të drejtuar një biznes vetiak.

Të promovojë integrimin social.

Të sjellë në fokusin e publikut problemin e sa e sa shqiptarëve që nuk e shohin të ardhmen e tyre në Shqipëri, por në vende të tjera.

Të rrisë ndërgjegjësimin e shqiptarëve për rrezikun e migrimit të paligjshëm.

Projektet:

“Kape të Ardhmen”, projekti kryesor për riintegrimin e të riatdhesuarve nga vende të ndryshme evropiane.
“Hidhe Hapin”, projekt për integrimin profesional të grave migrante të brendshme.

Projekte në të cilat është përfshirë Shoqata “Shpresë për të Ardhmen”:


Në partneritet me IOM:

VARRP (Programi i asistencës për të Kthyerit Vullnetarisht), i iniciuar nga IOM Londër.
HLWG — Projekti “Nxitja e Riintegrimin të Qendrueshëm në Shqipëri, Provincën e Kosovës dhe Maqedoni, duke forcuar kapacitetin e OJF-ve vendase për t'u siguruar shërbime të kthyerve”.

Në partneritet me COOPI (Bashkëpunimi Ndërkombëtar):

ALNIMA— projekt për të përmirësuar kushtet e jetesës të migrantëve të parregullt të zgjedhur nga Shqipëria, Nigeria dhe Maroku dhe për të rritur shanset për një riintegrim pozitiv të tyre në vendin e origjinës.

ALBAMAR — Implementimi i një mbështetje të integruar për emigrantët e kthyer forcërisht ose vullnetarisht nga Italia.



Shoqata “Shpresë për të Ardhmen”

Bulevardi “Gjergj Fishta”

Kulla 8, Ap.11, Tiranë

Tel./Fax: (04) 224 033

E-mail: shprese@shprese.org / kape@shprese.org

www.shprese.org

Shoqata “Shpresë për të Ardhmen”



“Kape të Ardhmen” dhe projekte të tjera

**INFORMACION,
KËSHILLIM DHE
MBËSHTETJE PËR
RIINTEGRIMIN E
EMIGRANTËVE
TË KTHYER DHE
MIGRANTËVE TË
BRENDSHËM**



Një përfitues në vendin e punës

Zhvillim i programit të riintegrit

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" u themelua në nëntor të vitit 1999 për të zbatuar projektin "Kape të Ardhmen", i iniciuar nga kapelani zviceran Dr. Patrice de Mestral. Zyra e projektit u hap në Prill 1999 për të ndihmuar në riintegrimin e të rinjve shqiptarë të kthyer nga Zvicra.

Qysh nga viti 2003 e në vazhdim në program janë përfshirë edhe të rinj të riatdhesuar nga vende të ndryshme evropiane si edhe migrantë të brendshëm.

Shtirja gjeografike: 16 rrethe të vendit



Gra dhe vajza në kursin e rrobaqepësisë



Të rinjtë e programit në një takim të "Shtëpisë së Hapur"

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" ofron:

Mundësi për të fituar një profesion pranë bizneseve të vogla dhe të mesme për një periudhë 9 mujore.

Mbështetje financiare për kurse trajnimi si kurse gjuhësh të huaja, kompjuteri etj.

Këshillim për probleme sociale dhe familjare

Organizon seminare trajnimi e mbështetje të biznesit të vogël.

Organizon takime të quajtura "Shtëpia e Hapur" me të rinjtë përfitues të programit dhe me punëdhënësit e tyre.

Organizon aktivitete të ndryshme social-kulturore për të promovuar riintegrimin e tyre social.

Organizon aktivitete për të ndërgjegjësuar të rinjtë për rrezikun e migrimit të paligjshëm.

Shoqata jonë i kushton një vëmendje të veçantë krijimit të kontakteve dhe zhvillimit të takimeve me autoritete dhe organizata të interesuara, me qëllim që të shkëmbehen informacione mbi migrimin.

.....
Donatorë:

HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane),

EED (Ndihma e Kishës Evangjeliste Gjermane).

Komisioni Evropian (Programi AENEAS)

IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin),

Donatorë privatë zviceranë

STATISTIKA (Maj 1999 – Qershor 2006)

1186 persona, 984 meshkuj dhe 202 femra janë regjistruar në zyrën e Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" që nga Maji 1999 deri në Mars 2006 dhe kanë marrë informacion dhe këshillim.

842 përfitues, 682 meshkuj dhe 160 femra janë ndihmuar nga programi ynë të mësojnë një profesion ose janë mundësuar të gjejnë një vend pune. Të gjithë këta persona kanë pasur akses të plotë në aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive të organizuara nga shoqata për riintegrimin social të tyre.

13 persona janë mbështetur financiarisht për hapje biznesi të vogël.

112 persona kanë përfituar ndihmë ekonomike në raste të veçanta.

Nga projekte të tjera:

**Projekti VARRP, referuar nga IOM:
74 përfitues**

**Projekti HLWG, referuar nga IOM:
8 përfitues**

**Projekti ALNIMA, referuar nga COOPI:
21 përfitues**